



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

K O N K L U Z I O N E
Per procedimin penal nr.3521/2020.

P a r a
Gjykates se rrethit gjyqesor .

TIRANE

Znj. K R Y E T A R E !
Z.GJYQTARE !

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor, pas marrjes e administrimit te provave te kerkuara nga organi procedues dhe mbrojtja e te pandehurve *Spartak Qoku, Franci Alimi, Emel Hajdaraj, Aleks Kala, Petro Sava, Klaudio Metaj dhe Andri Kraja* u provua si me poshte vijon:

Me dt.22.05.2020, rreth ores 04.40' ne rrugen "Frederik Shiroka", pallati Nr.44/2, Ap.3-Tirane, është tentuar te vidhet me arme apartamenti i shtetasit Endri Mosko.Nga pamjet filmike te administruara rezulton se ne vjedhje kane marre pjese tre autore, njeri prej tyre ka bere rolin e rojes ndersa dy autoret e tjere jane ngjitur ne ballkonin e apartamentit. Personi qe ka qendruar ne rolin e rojes, pasi dy nga autoret kane vendosur shkallet dhe jane ngjitur ne ballkonin e apartamentit i ka hequr ato duke i larguar ne nje distance rreth 50metra nga pallati duke i fshehur në një lulishte.Nga perleshja ne ballkonin e baneses, shtetasi Endri Mosko ka arritur qe ti shtyjë te dy autoret jashte ballkonit te apartamentit te tij dhe ata jane larguar me te shpejte.Gjate perleshjes, ne ballkonin e apartamentit njeri nga autoret mbante në dorë nje pistolete dhe gjate rimbushjes se armes i ka rene nje fishek ne ballkon, ndersa bashkeautori i cili qendronte poshte pallatit i thoshte "vrite, vrite".

Nga akti i ekspertimit balistik nr.4476, dt.03.06.2020, rezulton se fisheku i sekuestruar ne ballkon/banese është fishek standard luftarak, kaliber 9mm, i cili perdoret si municion per pistoletat e kalibrit 9mm dhe automatiket MPS, UZI dhe BERETA ,te kalibrit 9mm.Nga akti i ekspertimit daktiloskopik nr.4390, date 01.06.2020, ka rezultuar se ne fishekun e mesiperem nuk jane evidentuar gjurme papilare te vlefshme per identifikim.

Shtetasja Jonida Mosko ne deklarimet e saj midis te tjerash thekson se, isha shtrire per te fjetur ne dhomen e gjumit te femijeve.Per nje moment m'u duk sikur isha ne ënderr dhe kur hap syte shoh nje person mashkull i veshur me te zeza, me kapele te bardhe, i moshes rreth 30vjeç.Ai ishte futur brenda ne ballkon dhe me njeren dore m'a bente me

gisht qe te hapja deren e ballkonit ndersa ne doren tjetër kishte nje arme zjarri, pistolete, te cilen e levizte nga lart-poshte dhe me thoshte hape se do te vras.Mora femijet afer vetes dhe thirra bashkeshortin(Endri Mosko) per ndihme i cili po flinte ne dhomen e tij te gjumit. Ai erdhi dhe me tha, ç'fare eshte kjo, dhe i gjuajti xhamit te deres se ballkonit duke e thyer dhe goditë me grushte personin i cili ishte ne ballkon dhe qe iku me pas. Pistoleta ishte e vogel.Ora ishte rreth 04.30'.Une nuk i kam fiksuar si fytyra autoret.Veshjen e njerit prej dy personave qe ishin e pershkova me lart ndersa tjetrin e kam degjuar qe i thoshte shokut te tij qe po perleshej me Endrin "vrite, vrite".

Shtetasi Endri Mosko ne deklarimet e tij midis te tjerash thekson se, rreth ores 04.30', te dt.22.05.2020, ndersa kam qene duke fjetur kam degjuar bashkeshorten time, Joniden qe bertiti.Jam ngritur dhe jam drejtuar nga dhoma ku po flinte bashkeshortja me femijet.Kjo dhome eshte me ballkon dhe ndodhet ne krah te rruges.Nga xhami i deres se ballkonit kam pare nje person ne ballkon, me nje arme tip pistolete ne dore i cili trokiste ne xham ndersa nje person i dyte qendronte tek dritarja e vetrates prej xhami te ballkonit.Kam goditur me grusht xhamin e deres se ballkonit i cili u thye dhe kam dalur ne ballkon dhe kam kapur per mesi njerin prej autoreve duke e shtyre drejt parvazit te ballkonit ku ishte personi i dyte.Ky i fundit, u hodh poshte ne soleten e katit te pare dhe pas tij edhe personi qe u perlesh me mua.Tek keto dy persona u afrua edhe nje i trete, i cili qendronte si roje dhe qe te tre u larguan ne drejtime te ndryshme.Me pas bashkeshortja ka njoftuar organet policore me telefon.Pasi u larguan keta persona, ne ballkon kam pare nje fishek arme zjarri.Sqaroj se, jam perleshur me personin qe kishte pistolete ne dore dhe e kam kapur nga gryka dhe ne momentin qe kam goditur xhamin kam demtuar edhe doren time.Gjate kesaj kohe, personi i cili qendronte ne parvazin e ballkonit i thoshte personit qe kishte armen, "vrite, vrite".Te dy autoret ishin me shtat rreth 1.75cm, kishin kapuçë xhupi ne koke dhe pjesen e gojes dhe hundes te mbuluar me nje cope me ngjyre te zeze.Kishin veshur rroba te zeza, fytyrat nuk kam mundur ti identifikoj. Sqaroj se objektet qe ndodhen prane baneses sime kane kamera vezhgimi.

Me dt.23.05.2020, rreth ores 15.43' me kane telefonuar me nje numer anonim, i cili me thotë; "*Endriti, ti je*", *une ju pergjigja*, "*po une jam, po ti kush je*", ai u pergjigj, "*une jam terrori i mengjezit*".E pyes se ç'fare donte dhe ai me tha, "*bej gati nje zarf brenda 10 ditesh ose merr avionin per rruge te larget*".Dyshoj se ky person duhet te jete njeri nga dy personat e ngjarjes se dt.22.05.2020.

Nga transkriptet telefonike rezulton se, ne daten 23.05.2020, ne oren 15:42':55", nga numri telefonik 0676922772 *eshte kercenuar shtetasi Endri Mosko* per te cilin ai ka bere kallezim penal.Nga verifikimi i numrit 0676922772, rezulton se eshte i regjistruar ne emer te shtetasit Nevruz Turku por qe perdorej nga i pandehuri **Spartak Qoku**.

Nga tabulatet telefonike rezulton se, numri 0676922772 qe perdorej nga i pandehuri Spartak Qoku ka komunikuar me numrin **0699689974**, qe perket shtetasit **Nertil Qazimi**, me te cilin ka komunikuar ne orare te ndryshme, nje dite para ngjarjes, ditën e ngjarjes dhe me pas, me dt.21.5.2020; dt.22.5.2020; dt.24.5.2020 dhe dt.25.5.2020.

Nga pamjet filmike te administrura rezulton se autoret jane larguar nga vendi i ngjarjes me nje automjet tip "Mercedez Benz", ngjyre blu e erret, me **targa AA 419 SB, te cilin e drejtonte nje person i katert**.Nga verifikimi i ketij mjete rezultoi se, ai eshte i regjistruar ne emer te shtetasit **Nertil Qazimi**.

Shtetasi Nertil Qazimi ka deklaruar se mjetin e mesiperm ja kishte dhene me qera per dy dite, shtetasit Taulant Braha, kundrejt hartimit te kontrates perkatese.Me Taulantin ka komunikuar nepermjet numrit telefonik 0693150000.

Me dt.22.05.2020, nga numri i mesiperm i ka telefonuar nje person i cili eshte prezantuar si kusheri i Taulantit dhe e ka pyetur per Taulantin pasi prej dy ditesh nuk kishin dijeni per vendndodhjen e tij.Po kete dite ne mbremje e ka telefonuar Taulanti nepermjet numrit telefonik **0676922772** duke i kerkuar qe te shtynte kontraten e marrjes se mjetit me qera edhe per dy dite te tjera.Pas dy ditesh e ka telefonuar perseri por numri dilte i mbyllur. Diten e peste nepermjet numrit 0676922772(S. Qoku), e ka njoftuar me sms/mesazh duke e vene ne dijeni se mjetin do ta linte te parkuar perballe dyqanit "Ozone", ne Astir. Te nesermen e kesaj dite, Nertili nuk ka shkuar per te marre mjetin ne vendin e mesiperm por ka shkuar nje dite me pas dhe ka konstatuar se mjeti ishte pa çeles dhe çelesat ishin ne kroskot.

Nga hetimi rezulton se, i pandehuri Spartak Qoku per te lidhur kontraten e qerases me shtetasin Nertil Qazimi per mjetin me targa AA 419SB, ka perdorur lejen e drejtimit te shtetasit Taulant Braha.Nga kontrolli i baneses se te pandehurit Spartak Qoku eshte gjetur midis te tjerash edhe nje leje drejtimi per automjete ne emer te shtetasit Taulant Braha e cila eshte sekuestruar me cilesine e proves me dokumente.

Shtetasi Nertil Qazimi thekson se mjeti i dhene me qera ka qene i pajisur me sistemin GPS gjate gjithë kohes dhe ka te regjistruar te gjithë intenerarin e rruges se ndjekur nga ky shtetas gjate kohes qe e ka patur mjetin ne perdorim.

Ne nje CD-i, te administruar me cilesine e proves materiale jane marre **te dhenat e regjistruara nga sistemi GPS**.Te dhenat e marra konfirmojne deklarimet e te pandehurit Spartak Qoku ne lidhje me intenerarin e rruges se pershkruar prej te pandehurve naten e ngjarjes.

Ne daten **29.05.2020**, ora 20.03', numri i telefonit **0676922772**(ne posedim te pandehurit Spartak Qoku) **i ka derguar sms numrit 0676928708** (qe i perket shtetasit **Petro Savo**), ne kete sms thuhet; "*shife na sajo ndonje gje, me vjen keq qe të ka perzier ty ne kete mes, une s'kam qene vetem, por vetë i katert aty, mire une, po ata te tjeret ç'fare mendojne per ty Petro*". Nga ana tjetere numri 0676928708(Petro Sava) i ka derguar disa sms numerit 0676922772(te pandehurit Spartak) duke i thene "*nuk di gjë Boli per ty*", "*Cerri po te shet avash avash*". *Nga biseda e mesiperme rezulton se shtetasi Petro Savo ka dijeni per tentativen e vjedhjes me arme.*

Gjithashtu, shtetasi Endri Mosko ka deklaruar se, ne **daten 1 Qershor** i eshte bere nje thirrje nga **numri 0693831712**(Spartak Qoku), rreth ores 20.30' ku i eshte thene se, "*Endri te lutem, na e mbyll kete çeshtje me shtetin, te kerkojme falje dhe nëqoftese na ndihmon me shtetin, ne do te tregojme se kush na solli tek ty,(kallauzin)*". Personi qe i telefonoi i thote gjithashtu se, "*ai Beratsi që ti mban afer, po na ndihmove me shtetin, ne do te sjellim Beratsin tek ty dhe, do të të tregojme fije e per pe, se kush na ka sjelle tek ty*". Ne oren 23.22', tek ky numer telefonik 0693831712(S.Q.), Endri ka derguar nje mesazh ku i ka thene se, "persa i perket informatorit ju kane drejtuar shume keq, se une nuk kam as lekë ne shtepi dhe se nuk mbaj njeri me rroge pasi une jam me rroge per vete".

Te nesermen, me **dt.02.06.2020**, ne oren 16.35',nga i njeiti numer 0693831712(Sp.Qoku) i kane ardhur edhe disa mesazhe te tjera, (te cilat shtetasi Endri Mosko i ka vendosur ne dispozicion te hetimit), nga permabajtja e te cilave u kerkohet atij qe ta mbyll kete çeshtje

me shtetin. Ne momentin qe kallezuesi (E. Mosko) eshte paraqitur ne komisariat, ka pare nje person qe po e shoqeronin punonjesit e Policise i cili rreth tre muaj e gjysem me pare, sapo kishte filluar karantina, se bashku me shtetasin Petro Savo (i cili eshte shoku i Endrit) kane ardhur tek pallati ku Endri ishte ne karantine pasi, Endri i kishte kerkuar Petros qe te shkonte ne shtepine e tij per te marre rroba. Petro Savo kishte marre nje makine me ngjyre te kuqe kabriolete, me tek dere, me dy vende ulese, ku shofer ishte personi qe ai pa ne Komisarjat per te cilin **mesoi se quhej Spartak Qoku**.

Me cilesine e proves jane administruar nga shtetasi Endri Mosko edhe mesazhet e shkembjere midis tij dhe te pandehurit Spartak Qoku te pershkruar si me siper.

I pyetur ne lidhje me ngjarjen e mesiperme ne pranine e avokatit mbrojtës, **i pandehuri Spartak Qoku** e ka pranuar autoresine e ngjarjes dhe sqaron se, eshte e vertete qe une se bashku me shoket e mij, **shtetasit Emel Fadil Hajdari**, shokun tjetër **Franci** mbiemri nuk po me kujtohet dhe punonjesin e gardes me emrin “**Gyli**” kemi shkuar per te vjedhur nje sasi kokaine prej 4kg ne banesen e shtetasit Endri Mosko te cilin e therrasin me pseudonimin “Boli”.

Dua te sqaroj me hollesi se, tre dite perpara se te ndodhte ngjarja e mesiperme jam takuar tek “Astiri”, poshte pallatit tim, me shtetasin **Klaudio Metaj** qe eshte nga Rresheni i cili më tha se, nëse kisha dijeni që dikush kishte sasi te medha lekesh ne shtepi, ti thoja, pasi ai njihite disa çuna nga Fushe-Kruja te cilet ishin profesioniste per te hapur dyer dhe per te bere grabitje. I thashe se do te interesohem sepse me kishte thene njëri se tre vete kishin leke, nderkohe une kam ikur ne shtepi ndersa Klaudio u largua.

Pas 15’ tek shtepia ime ka ardhur shtetasi Andi Kraja i cili me thote, hajde te shkojme ne Durres të të jap nje dreke dhe me kete rast do te shikonte edhe shtepine qe i ishte prishur nga termeti. Kemi ikur qe te dy per ne Durres, me makinen e Andit, te markes Ford, ngjyre e bardhe dhe kemi ngrene dreke ne Plazh- Durres. Andi nuk ka shkuar tek apartamenti i tij pasi pallati ishte i shkaterruar dhe nuk rrezikoi dhe pastaj jemi kthyer per ne Tirane, ku ai me ka lene mua tek pallati im dhe vete iku per ne shtepine e tij.

Ne momentin qe ishim ne Durres, Klaudio Metaj me ka marre ne telefon duke me thene “shiko se duhet te takohemi se i kishte takuar ata shoket e tij per te cilet me la porosi” dhe une i thashe se po vija per ne Tirane.

Pasi Andi ishte larguar, pas rreth 15’ - 20’, **Klaudio Metaj** ka ardhur poshte pallatit tim se bashku me dy shoket e tij, **Francin te cilin e kisha shok edhe une** dhe nje person tjetër te cilin nuk e kisha pare me pare, i cili nuk u prezantua me emer por me tha se ishte nga Mamurrasi ose Laçi, por te nesermen me ka thene se **quhej Gyli** dhe se punonte tek Garda e Republikës. Me makinen Audi A3, me ngjyre te zeze te punonjesit te Gardes me emrin Gyli kemi shkuar qe te kater ne Selite.

Pasi jemi futur ne kete rruge, ne te perpjete kemi marre majtas rreth 200 metra ku une ju kam treguar nje vile kater kateshe te cilen ma kishte treguar shtetasi Andi Shkurti, si person qe kishte leke dhe nje sasi prej 2 kg e 800 gram kokaine ne shtepi. Ky personi i viles ishte nga Berati, kishte nje Benz 63 S, me benzine, me ngjyre te bardhe, te cilin e mbante here me targa Zvicre dhe here me targa Tirane. Pasi ju tregova shtepine qe do te vidhnim jemi kthyer se bashku ku me lane tek pallati im dhe ata u larguan se bashku, ku kemi lene orare qe te takoheshim ne oren 09.30’ tek pallati im.

Te nesermen ne oren 09.30’ ka ardhur tek pallati im vetem punonjesi i Gardes me emrin **Gyli** me makinen e tij audi, targat e se ciles nuk i kam fiksuar me ka marre ne makine dhe kemi shkuar tek shtepia e Francit tek Komuna e Parisit, pallatin e te cilit e kam fiksuar

(Franci me ka thene se ishte ne arrest shtepie pasi me tha se kishte vjedhur zonjen e keshillit te mire, por se i kishte ikur policise ate dite). Kemi marre **Francin** ne makine **dhe te tre** kemi shkuar tek shtepia ne Selite qe ishim nje dite me pare, ku Gyli ka qendruar ne makine qe te ishte ne gadishmeri per tu larguar sapo te kryenim vjedhjen, ndersa Franci ka marre pistoleten e Gylit e ka futur ne brez.

Une me Francin jemi ngjitur ne katin e kater te viles ku i kemi rene ziles dhe sapo ta hapte i zoti i shtepise, *Franci do ti vinte pistoleten ne koke* dhe do ta grabisnim. I kemi rene ziles disa here por askush nuk e hapi deren. Te dy kemi zbritur poshte dhe kemi ndenjtur poshte viles, diku aty prane ne makinen e parkuar dhe jemi pozicionuar qe te kishim pamje, nese do vinte ne banese personi me qellim qe ta grabisnim dhe kemi qendruar aty rreth kater ore.

Ne nje moment, qe te tre (Spartaku, Franci dhe Gyli) kemi hyre ne nje lokal perballe Mullirit te Vjeter ku jane disa xhiro pica ne fillim te rruges per Selite dhe kemi pire kafe. Pas gjysem ore kemi shkuar perseri tek vila kater kateshe ku kemi pare personin qe do te grabisnim i cili ishte ulur poshte tek trotuari dhe qendronte i shoqeruar me nje person tjeter, tip tullac, me trup te madh i cili kishte nje makine tip Audi A6, me ngjyre te bardhe. *Franci tha se nuk behet më tashti kjo pune por te ktheheshim naten, ne oren 12.00 te nates qe ta benim sipas menyres se Francit (ku do ti binim deres dhe do te shtireshim si police.* U larguam prej aty dhe mua me sollen tek nje lulishte, tek Mozaiku, me lane aty duke me thene se ne oren 12.00' te nates do më prisnin po aty dhe të isha gati, pa telefon me vete.

Une kam ndenjtur aty rreth nje ore pasi kam pire nje cigare hashash pastaj kam ikur ne shtepi. Kam ngrene buke, kam marre makinen qe kisha marre me qera dhe kam shkuar tek Mozaiku i Tiranes rreth 40' perpara, kam pritur dhe nderkohe ka ardhur vetem Gyli ne oren 12.00' te nates, ndersa Franci ishte ne shtepi dhe na priste qe te shkonim dhe ta merrnim. I kam thene Gylit se do te vidhnim nje argjendari qe ishte ngjitur me kryqezimin e "21 Dhjetori-t", ngjitur me funeralin, dhe te mos shkojme tek vila kater kateshe pasi personi qe do te grabisnim kishte ikur ne Berat. Une e thashe kete sepse mesova nga Andi Shkurti se ky person qe do te grabisnim kishte nje femije te vogel dhe nuk doja qe ti ndodhte diçka e keqe pasi une vete kam dy nipa.

Ne kete moment Gyli me tha, hajde te ikim te marrim Francin qe te *kryenim vjedhjen e Argjendarise*, por une i kam thene, shko merre ti Francin pasi une po pres djalin tjeter qe e di se ku ndodhet argjendaria. Gyli ka ikur me makinen e tij dhe ka marre Francin dhe nderkohe aty ka ardhur shoku im, Emel Hajdari dhe pas pak minutash kane ardhur edhe Gyli me Francin. Qe te kater kemi bere muhabet rreth 4' dhe pastaj rame dakort qe te shikonim se ku gjendej Argjendaria qe do te vidhnim. Pasi kemi shkuar dhe e kemi pare argjendarine jemi pozicionuar, Gyli ka ndenjtur i parkuar me makinen e tij tek vendi i taksive, mbrapa dy taksive sepse, nese do te arrinim te nxirrnim kasaforten e argjendarise do te vinte me makinen e tij qe ta transportonim.

Emeli ka ndenjtur tek poliklinika nr.9, si roje, ndersa une dhe Franci kemi shkuar nga mbrapa Argjendarise qe te mos na shikonin njerezit dhe pasi Emeli te na jepte sinjalin se nuk kishte njerez, une dhe Franci do te afroheshim, po ashtu dhe Emeli dhe do te futeshim ne argjendari per te vjedhur. Duke shkëmbyer cigare me Francin dhe duke bere muhabet mbrapa argjendarise, Franci me tha qe te mos e vidhnim argjendarine sepse do binte alarmi, kasaforta do jete e ngjitur ne mur dhe nuk do ta realizonim dot.

Gjithashtu Franci me tha se edhe nese e vidhnim argjendarine, nuk do te kryenim vjedhjen ne banesen e “Bolit” pasi policet do te ishin neper kembë, ne lagje dhe per kete vendosem qe te shkonim dhe te kryenim grabitjen ne banesen e “Bolit”.

Pas kesaj bisede une dhe Franci kemi shkuar tek Emeli dhe Gyli dhe qe te kater biseduam qe te shkonim per te vjedhur banesen e “Bolit”.

Ne fillim kemi shkuar dhe kemi parkuar tek Mozaiku qe te dyja makinat, ngjitur me njera tjetren dhe kemi biseduar perseri qe te shkonim dhe te hynim per te vjedhur ne shtepine e Bolit pasi une kisha informacion nga Andi Shkurti se Boli kishte nje qese dixhitali plot me leke, kishte 3-4 kilogram kokaine te paster dhe rreth 10 ora floriri te kushtueshme, vetura te kushtueshme si benz, mazerati etj.

Gyli tha qe te mos e benim ate nate grabitjen pasi me vete kishte pistoleten e punes dhe nuk donte qe ta benim me pistoleten e punes por ta benim grabitjen te nesermen pasi ai do te siguronte arme te tjera, ne Fushe-Kruje, ku na tha se do siguronte çfaredolloj arme qe te kishim nevojë. Franci ju lut Gylit qe te na jepte pistoleten e tij te punes dhe nese diçka shkonte keq ai do te deklaronte se ja kishin vjedhur dhe po te donte te thoshte se ja kishte vjedhur Franci. Pas kesaj bisede *Gyli ra dakort dhe ja dha pistoleten e tij te punes Francit*, ndersa vete ka ndenjtur ne makinen benz qe kisha marre me qera me qellim qe te ishte gati per te ikur kur te kryenim vjedhjen. Une, Emel Hajdari te cilit i therrasim “Cuci” dhe Franci jemi nisur ne drejtim te pallatit te Bolit.

Ne fillim kemi kontrolluar zonen rreth e perqark dhe kemi pare qe nuk ishte e mundur qe te hipnim pa shkalle. Emeli tha se e dinte se ku gjendeshin nje pale shkalle druri, ne katin e fundit te nje pallati qe ndodhej dy pallate me tutje ku do te kryenim vjedhjen.

Une i kam thene se nuk hipja dot te merrja shkallet pasi kisha probleme me mushkërine dhe atehere kane shkuar Franci me Emelin dhe kane marre shkallet prej druri dhe pasi e zbriten poshte i kemi fshire shkallet me nje bluze qe kishim veshur pasi i kishim prekur me duar dhe kishim frike se mos linim gjurmet dhe pasi kane hequr çorapet nga kepuçet i kane veshur tek duart dhe i kane mbajtur ne krahe.

Pasi shkuam tek pallati i Bolit, une dhe Franci kemi vendosur shkallet ne anesore te pallatit, jemi futur dhe kemi qendruar tek hyrja ne katin e pare. Emeli ka shkuar tek kryqezimi i rruges afer lokal “Oslo” dhe nderkohe qe ne u afruam tek shkallet, Emeli na dha shenje me dore qe te fillonim. Une me Francin kemi ngritur shkallet dhe i kemi vendosur ngjitur me ballkonin. Ne fillim jam ngjitur une dhe pas meje eshte ngjitur Franci, ndersa Emel Hajdari pasi jemi ngjitur ne tek ballkoni, ka ardhur dhe ka hequr shkallet me qellim qe te mos i shikonte ndonje kalimtar. Ne (Spartaku dhe Franci) pasi te kryenim vjedhjen do te hidheshim nga ballkoni, keshtu e kishim biseduar me pare.

Pasi kemi hipur ne ballkon, kemi pare se dritarja e dhomes ishte e mbyllur nga brenda dhe ne ate moment, *Franci me ka dhene pistoleten mua dhe une kam trokitur ne xhamin e dritares*, pasi e dinim sipas fjaleve te Andi Shkurtit se Boli ishte vetem ne banese. Pasi kam trokitur, nga krevati kemi pare se eshte zgjuar gruaja e Bolit e cila menjehere ka bertitur dhe thirrur Bolin i cili ishte ne dhome tjetere. Boli ka ardhur menjehere duke bertitur dhe uluritur ndersa une i thosha “hape deren, policia”, edhe Franci me thoshte thuaj, “jemi policia se nuk ta hap ndryshe”.

Boli ka thyer xhamin e dritares se dhomes dhe ka arritur qe te me kapte mua per fyti, ndersa une perpara se te me kapte per *fyti bera mbushjen e pistoletes qe me kishte dhene Franci* e cila kishte qene e mbushur pasi Franci e kishte mbushur me pare. Ne momentin qe bera rimbushjen e pistoletes, nje fishek ose dy kane rene ne ballkon. *Kur Boli me kapi*

per fyti, une ja kam dhene pistoleten Francit pasi ajo me ngeci ne momentin e rimbushjes, ndersa Emeli bertiste nga poshte "vrite, vrite". Franci filloi te qellonte me shkelma dhe grushta ne drejtim te Bolit, dhe ketu kam perfituar une dhe jam shkeputur duke rene nga ballkoni. Pas meje eshte hedhur Franci dhe qe te tre kemi ikur tek Gyli. Sqaroj se gjate renies, une jam vrare pak ne koke dhe kemben e djathte por, ne koke nuk kam shenje ndersa tek komba e djathte me ka ngelur nje shenje e vogel.

Pasi kemi ikur tek Gyli qe priste ne makinën benz qe kisha marre me qera, te kater kemi ikur me makine te cilen e drejtonte Gyli. Jemi futur ne rrugen "Naim Frasheri", kemi dale ne rrugen e "Kavajes", pastaj ne rrugen "Myslym Shyri", ne rrugen perpara Drejtorise se Policise Tirane, kemi kaluar uren, kemi vazhduar rrugen "Sami Frasheri" drejt, kemi dale tek sheshi "Willson", jemi rrotulluar djathtas dhe tek semafori i pare, tek stadium Dinamo jemi futur majtas dhe kemi shkuar tek pallati qe banonte Franci, i cili me ka thene se banonte ne katin e dyte te ketij pallati.

Pasi ka zbritur Franci per te shkuar ne shtepi, na ka thene se do bente dy tre telefonata qe ta mbyllte kete gje qe beme. Une, Emeli dhe Gyli kemi ndenjurr rreth 20' qe te prisnim Francin te zbriste nga shtepia dhe pasi ai ka ardhur, na tha se tani po vinte nje shoku i tij nga Shkodra dhe do ta mbyllte kete pune me Bolin dhe me policine nese ishte bere e madhe. Para se te ndaheshim nga Franci, ai i kerkoj numrin e celularit Emelit duke i thene se do ta lajmeronte ne vazhdim per ta mbyllur si muhabet.

Pas kesaj, Une, Gyli dhe Emeli kemi ikur me makinën benz qe e drejtonte Gyli tek Mozaiku, tek makina e Gylit, i cili i ka hipur ne makinën e tij dhe pasi na pyeti se ku do shkonim, na tha gjithashtu qe te mos flisnim per te ç'faredo qe te ndodhte sepse po te flisnim nuk do i kishim punet mire me të, pastaj na percolli deri tek dogana me makinën e tij duke ecur perpara dhe ne, në makinën time qe kisha marre me qera ecnim mbrapa dhe ne rast se do te na ndalonte policia, Gyli do te thoshte se ishim me të dhe nuk do te kishim probleme. Gyli eshte kthyer perseri per nga "Zogu i Zi" por na tha se do te ikte ne Laç pasi sipas tij, ne dreke do te ishte ne pune.

Une dhe Emeli kemi shkuar ne shtepite tona pasi Emeli e ka shtepine tek pallati perballe pallatit tim. Qe nga ajo dite, une jam takuar vetem me Emelin çdo dite ndersa me Francin dhe Gylin nuk jemi takuar dhe as kemi folur ne telefon.

Sqaroj se Andi Shkurti te cilin e therrasim "Çerri" disponon numrin e celularit 0693452117, ne telefon ja kam shenuar numrin me emertimin "Cerri Mami Mozes", Klaudio Metaj disponon numrin cel. 0684830796, te cilin une e therras "Lupino" qe do te thote ujk i vogel ne italisht, dhe numrin e telefonit me kete emertim ja kam shenuar ne telefon, Emel Hajdari disponon cel. 0697934023, te cilin e therrasim "Cuci" dhe numrin e telefonit me kete emertim ja kam shenuar ne telefon.

Shtetasin Petro Sava, e njoh, e kam çun lagje dhe mbas dy diteve qe ndodhi ngjarja tek banesa e Bolit, e kam thirrur dhe e kam takuar pasi Andi Shkurti me ka thene se eshte Petro Sava ai qe ka spiunuar tek Boli se kush kishin qene personat qe i ishin futur ne shtepi dhe sipas Andit, Petro i kishte thene Bolit "shiko se ato shoket e Çerrit jane shume te rrezikshem", gje te cilen ma tha vete Çerrit dy dite pas ngjarjes. Une e kam pyetur "Çerrin" (A. Shkurti) se ku e kishte marre kete informacion dhe ai me tha se, e kishte marre Boli ne telefon dhe i kishte thene "hajde urgjent tek shtepia" dhe pasi hyra tek shtepia e Bolit, Boli i kishte nxjerre 1000 euro dhe nje tufe bizhuteri duke i thene "jepja atyre gangsterave te tu, se keto kisha ne shtepi, s'kam te tjera", nderkohe qe Andi Shkurti i kishte thene se nuk kam gisht ne kete pune, po shiko se kete pune ta ka bere

Petro dhe shoket e tij.Pas kesaj bisede me Andin, kam marre ne telefon Petron dhe kam biseduar me te, ku ai me eshte betuar se nuk kishte dhene informacione per Bolin, ndersa une i kam treguar se kush kishte marre pjese ne grabitjen tek shtepia e Bolit.

I pandehuri Aleks Kala(Gyli) ne deklarimet e tij te dhena ne prani te mbrojtjesit midis te tjerash ka deklaruar se, nuk kam qene prezent ne vendin e ngjarjes. Persa i perket armes se sherbimit dua te them se arma me eshte grabitur nga Franci.Fisheket e gjetur ne banese i kam marrë ne Zall-Herr kur kam bere qitje.

Ne nje CD-i te administruar me cilesine e proves materiale jane marre te dhenat e regjistruara nga sistemi GPS.Eshte bere kqyrja e CD-se me te dhenat e GPS-it ku tregohet intenerari i levizjes se mjetit me targe AA 419 SB, te marre me qera dhe i perdorur nga i pandehuri Spartak Qoku.Eshte bere printimi i tabelës ku jane te evidentuar targa e mjetit AA 419 SB, koha dhe intenerari i levizjes se mjetit.

Ne oren 00:03 mjeti me targe AA419SB rezulton te jete, ne Rr.”Sander Prosi”, ish zdruktharia, Njesia Bashkiake Nr.7 Tirane ku qendron deri ne oren 0:53.Ne oren 0:53 mjeti eshte ne Rr. “Mihal Ciko” ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.7,ku qendron deri ne oren 0:55.Ne oren 0:56 largohet ne Rr.”Naim Frasheri” ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.9, kalon ne Rr.”Halim Xhelo”, Njesia Bashkiake Nr.10, ne Rr.”Muhamet Gjollesha” ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.7 ne oren 0:57, ne Rr.”Frederik Shiroka” ne oren 0:58, ne Rr.”Naim Frasheri”, ne oren 0:58, ne Rr.”Muhamet Gjollesha”, ne oren 0:59, ne Rr. e “Kavajes” ish zdruktharia, ne oren 1.05, ne Rr.”Kavajes” ish qendra Condor, ne 1:06, ne Rr.”Ndre Mjeda”, ne oren 1:07,Rr.”Artan Lenja”, ne oren 1:08, ne Rr.”Dafinave”, ne oren 0:08, ku qendron deri ne oren 1:10.Ne oren 1:11’ rezulton qe mjeti eshte ne Rr.”Teodor Keko”, Fushe Mezez, ne oren 1:13 Rr.”Teodor Keko”, Kastrati, deri ne oren 1:24.Ne oren 1:24 rezulton te jete Rr.”Teodor Keko” fusha e druve, Njesia Bashkiake Nr.11, ne oren 1:25 Rr.”Dritan Hoxha” ish fusha e druve, Njesia Bashkiake Nr.11, ne 1:26 Rr. ”Dritan Hoxha”- “Zogu i Zi”, ne oren 1:27 ish fusha e druve, Njesia Bashkiake Nr.7, kalon ne Rr.”Muhamet Gjollesha” ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.11 deri ne oren 1:28.Ne oren 1:28 Rr.”Mihal Ciko”, ne oren 1:29 Vila 31, Rr.”Thoma Kaçorri” ish zdruktharia njesia bashkiake nr.9.Ne oren 1:30 Rr.”Frederik Shiroka” ish zdruktharia, njesia bashkiake Nr.9 deri ne oren 2:12.Ne oren 2:13 leviz ne Rr.”Kavajes” ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.5 deri ne 2:27.Ne oren 2:28 ne Rr.”Frederik Shiroka” ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.7,ne Rruga ”Naim Frasheri” ne oren 2:28 deri ne oren 2:36.Ne oren 2:36 perseri ne Rr.”Kavajes” ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.5 deri ne 2:38.Ne oren 2:39, date 22.05.2020, ish shtepia botuese “8 Nentori”, Rruga ”Frederik Shiroka” ish zdruktharia, kalon ne Kingston, Rr.”Sander Prosi” 2:39, Mozaiku i Tiranes Rr.”Sander Prosi”, Nj.Bashkiake Nr.7 ne oren 2:40, Rr.”Naim Frasheri”, 2:40 me pas ne Rr.”Muhamet Gjollesha”, ish zdruktharia ne oren 2:41’ ku qendron deri ne oren 2:46 deri ne 2:51.Me pas ne oren 2:47 Mozaiku i Tiranes, ne oren 2:52.Ne oren 2:53 Rr.”Mihak Ciko’ ish zdruktharia deri ne oren 3:01.Ne oren 3:01 Mozaiku i Tiranes, ora 3:09 Rr.”Mihal Ciko”.Ne oren 3:17 rezulton ne Rr.”Sander Prosi” deri ne oren 3:24.Ne oren 3:32 Rr.”Mihal Ciko” deri ne oren 3:47.Ora 3:47

Rr."Sander Prosi" deri ne oren 3:49.Me pas kalon perseri ne Rr."Mihak Ciko" ne oren 3:50 deri ne oren 4:13.Ne oren 4:14,kalon ne Rr."Sander Prosi" ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.7,kalon ne Rr."Frederik Shiroka", Bar Oslo ne oren 4:15,ne Rr."Mihal Ciko" ne oren 4:16 kthehet ne Rr."Sander Prosi" dhe "Frederrick Shiroka" ne oren 4:16 dhe 4:17, Rr."Mihal Ciko" ne oren 4:18, Rr."Sander Prosi",ora 4:19 Rr."Mihal Ciko", kalon ne Mozaiku i Tiranës ne oren 4:20 ku qendron deri ne 4:28.Ne oren 4:35 Rr."Mihak Ciko" deri ne pren 4:40.Ne oren 4:41 Instituti i Sigurimeve shoqerore, "Vellezerit Manastirli", ne oren 4:42, Rr, "Durrësit" ish Merkata Njesia Bashkiake Nr.10, Rr."Mine Peza" Zogu i Zi, ne oren 4:43, Rr."Qemal Stafa", Rr."Durrësit" ora 4:43, ish zdruktharia Rr."Durrësit", ora 4:43,Njesia Bashkiake Nr.9 deri ne oren 4:44, Rr "Asim Vokshi" ora 4:45 deri ne 4:57, sheshi "Karl Topia" ora 4:58, Rr "Bogdaneve" ora 4:59, Rr."Kavajes" ora 5:00.Rr."Mujo Ulqinaku" ish zdruktharia Njesia Bashkiake Nr.10,Rr."Him Kolli" ora 5:01, Rr."Mujo Ulqinaku" ora 5:02, Rr."Kavajes" ora 5:05, Rr."Islam Alla" ora 5:06, Rr."Sami Frasheri" Friend's book House, ora 5:06, Rr."Sulejman Delvina" ora 5:07, Rr."Medar Shtylla"- Oslo ora 5:08,Rr."Dhimiter Shuteriqi" ora 5:09, Farke ora 5:10, Unaze e Re Farke, 5:10,Rr."Bill Klinton" Farke ora 5:12 deri ne 5:32.Rr."Rrapo hekali" ora 5:33, Rr."Bill Klinton" ora 5:34, Rr."Rrapo Hekali" ora 5:39 deri ne 5:41.Unaze e re Farke ora 5:41, Rr.Sefer kondi ora 5:42,Rr."Muhedin Llagani" ora 5:43,Rr."Kavajes" ish fusha e druve ora 5:44,Rr "Kavajes" ora 5:45,Rr."Sander Prosi" ora 5:45, Rr."Muhamet Gjollështa" ora 5:46, Rr."Naim Frasheri" ora 5:46 deri ne 5:49.Jepet ne vijimesi intenerari i levizjes se mjetit me targe AA419SB deri ne oren 23.56', date 22.05.2021.

Intenerari i levizjes se mjetit me autoret e vjedhjes me arme (mbetur ne tentative) te baneses se shtetasit Endri Mosko, i regjistruar ne sistemin GPS, perputhet plotesisht me intenerarin e levizjes se mjetit te deklaruar nga i pandehuri Spartak Qoku, perpara, në kohen e kryerjes dhe pas ngjarjes(vjedhjes me arme).

Nga akti i ekspertimit balistik nr.6466, dt.22.7.2020, te kryer mbi armen e zjarrit, tip pistolete, te sekuestruar te pandehurit Aleks Kala, me numer P52817Z, e markes "Beretta", eshte e rregullt teknikisht dhe realizon qitje normalisht.Gjithashtu, ***pese fisheket*** qe ka pasur kjo arme perdoren si municion per pistoletat e kalibrit 9mm dhe automatiket MPS, UZI dhe Beretta.Fisheku i sekuestruar ne ballkonin e baneses se shtetasit Endri Mosko rezulton se eshte fisheke qe perdoret si municion edhe nga pistoleta e markes "Beretta" e sekuestruar te pandehurit Aleks Kala.

Po keshtu, me aktin e ekspertimit teknik balistik nr.167, date 22.06.2020, te kryer mbi fisheket e gjetur ne banesen e te pandehurit Aleks Kala, rezulton se, ***34-cope fisheke*** te kalibrit 9mm, qe perdoren si municion per pistoletat, 9-cope fisheket e kalibrit 7.62mm qe perdoren si municion per revolveret e markes "Nagant" dhe 6- fisheket e kalibrit 9mm qe perdoren si municion per revolveret e markes "Magnum", jane ne gjendje te rregullt teknike dhe realizojne qitje normalisht.

Nga kqyrja e pamjeve filmike te marketit "Anasa Market", te administruara me cilesine e proves jane administruar pamjet filmike te kamerave te vezhgimit, nga ora 03.00' deri ne oren 05.00' te dt.22.05.2020.Nga kqyrja e ketyre pamjeve jane fiksuar momentet e

ardhjes se autoreve te ngjarjes, marrjes se shkalleve dhe vendosjes se tyre ne ballkonin e shtetasit Endri Mosko.

Edhe nga pamjet e marra nga pamjet filmike te regjistruara nga kamerat e sigurise "01", te cilat mbulojne nje pjese te rruges "Naim Frasheri" shihet momenti i ardhjes se tre autoreve, te cilet mbajne kostume sportive, si ngjyre gri, me kapuce ne koke si dhe momenti qe mbartin ne krahe shkallen qe me pas e vendosin tek ballkoni i te demtuarit.

Me cilesine e proves jane administruar nga shtetasi Endri Mosko edhe mesazhet e shkembyera midis tij dhe te pandehurit Spartak Qoku te pershkruar si me siper.

Ne deklarimet e tij midis te tjerash, i pandehuri Aleks Kala ka deklaruar se, ka njohje me te pandehurit Franci Alimi e Klaudio Metaj, fisheket e gjetur ne banese i ka marre ne Zall-Herr kur ka bere qitje pasi eshte punonjes i Gardes se Republikes dhe eshte i pajisur me certifikate per qitje ne distance te largëta, ndersa persa i perket armes se sherbimit, ate ja ka vjedhur shtetasi Franci Alimi.

Nga pergjimi telefonik i realizuar midis te tjerash rezulton se, nga komunikimet midis te pandehurit Spartak Qoku e Petro Sava, rezulton se ky i fundit jo vetem ka dijeni per vjedhjen e baneses se shtetasit Endri Mosko por e siguron ate(Spartakun) se Endri Mosko(Boli) nuk ka dijeni per atë(Spartakun).(Pergjimi i dt.29.05.2020, me tekst "*Villa nuk di gje Boli per ty*", "*Çerri po te shet avash- avash*", "*do vij te sqaroj une per pak*" etj).

Edhe shtetasi Andi Kraja, ne komunikimin me te pandehurit Spartak Qoku e Petro Sava rezulton te jete ne dijeni te vjedhjes me arme te baneses se shtetasit Endri Mosko si dhe te autoreve te vjedhjes.(Pergjim i dt.29.05.'20, midis te pandehurit Andi Kraja e Spartak Qoku (nr....077Sp.Q.- "he mo Kraje,- nr...530(A. K.)- ku je lal, ...077- ketu poshte' ...530- poshte jam edhe une,...077 hajde lal ktu te kafja te kta cunat ktu"etj.;

Nga informacioni i marre nga kompanite celulare si dhe nga materiali pergjues rezulton se numri530 qe i perket shtetasit Andi Kraja, me dt.20.05.2020 dhe 21.05.2020 komunikon me nr.....772, ne perdorim nga shtetasi Spartak Qoku.

I pandehuri Spartak Qoku deklaroi se shtetasin Andi Kraja e kam shok femijerie dhe i kam treguar per grabitjen tek shtepia e "Bolit" dhe ai me ka thene se ke bere gabim.

Me dt.29.05.2020 numri telefoni772 (Sp.Qoku) i dergon nje sms nr....708(P.Sava) ku midis te tjerash i thote: "*shife na sajo ndonje gje, me vjen keq qe te ka pezier ty ne kete mes, une skam qene vetem, por vete i katert aty, mire une, po ata te tjeret cfare mendojne per ty Petro*" ndersa ky i fundit i dergon nje sms duke i thene "*nuk di gje Boli per ty*" etj.

Nr.....708 qe i perket shtetasit Petro Sava komunikon edhe me shtetasin Andi Kraja(...530) dhe numrin.....077 qe i perket shtetasit Elvis Qoku (vellai i Spartakut).

Nga komunikimi me sms midis te pandehurit Spartak Qoku me shtetasin Endri Mosko, i pandehuri Spartak midis te tjerash i shkruan "*une skam qene vetem por vet i kater(4) aty*" dhe i kerkon atij qe te mbylle kete çështje me shtetin se do ti tregoj gjithçka rreth ngjarjes dhe pjesemarrësve ne krim.

Nga transkriptet telefonike rezulton se me dt.02.06.2020, nr.0693831712, ne perdorim nga i pandehuri Spartak Qoku ka komunikuar me sms me shtetasin Endri Mosko te cilin e kerconon me jeten e tij e te femijeve dhe i kerkon te heq dore dhe te mos e ndjek çështjen me shtet duke i bere te ditur se e kane bere ata vjedhjen.Kanosja e bere menjehere pas ngjarjes eshte me natyre serioze dhe krijon bindjen tek i demtuari se do te kryhet. Menjehere pas kanosjes shtetasi Endri Mosko eshte paraqitur ne organet policore ky ka

kallzuar ne lidhje me kanosjen si dhe ka dorezuar edhe sms e shkëmbyera me personin që e kanosi.

Ne rrethanat e mesiperme, ***i pandehuri Spartak Qoku*** ka konsumuar edhe elementet e figures se vepres penale te “Kanosja per te mos kallezuar” parashikuar nga neni 311 i K.Penal.

I pandehuri Klaudio Metaj ne deklarimet e tij midis te tjerash thekson se ka njohje me te pandehurit Spartak Qoku, Aleks Kala e Franci Alimi.

Ne rrethanat e mesiperme, ***te pandehurit Spartak Qoku, Franci Alimi, Emel Hajdaraj dhe Aleks Kala*** ne bashkepunim me njeri tjetrin kane konsumuar elementet e figures se vepres penale te “Vjedhja me arme” parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 te K.Penal (Vjedhja me arme, ne bashkepunim e mbetur ne tentative e baneses se shtetasit Endri Mosko).

I pandehuri Spartak Qoku duke mbajtur pa leje arme zjarri luftarake ka konsumuar edhe elementet e figures se vepres penale te “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit” te parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal ndersa ***I pandehuri Franci Alimi*** duke mbajtur ne më shume se nje here (në dy rastet e tentatives se vjedhjes se banesave) arme zjarri pa leje ka konsumuar vepren penale te “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit” te parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal (Sipas Ligjit nr.44/2019, Per disa shtesa e ndryshime ne Ligjin nr.7895, dt.27.01.1995, Kodi Penal i Rep.Shqiperise, i ndryshuar.)

Te pandehurit Spartak Qoku, Franci Alimi dhe Aleks Kala, ne bashkepunim me njeri tjetrin kane tentuar te vjedhin me arme Vilen kater kateshe ne pronesi te shtetasit Lorenc Letini (Mustafaj) ne Selite- Tirane, duke konsumuar elementet e figures se vepres penale te “Vjedhja me arme” parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 te K. Penal.

Te pandehurit Spartak Qoku, Franci Alimi, Emel Hajdaraj dhe Aleks Kala, duke bere njohjen e mjedisit ku ndodhej Argjendaria te cilen planifikonin ta vidhnin si dhe duke siguruar mjetet per vjedhje, sikurse eshte arma e zjarrit dhe makina e cila do te sherbente per transportimin e sendeve te vjedhura, kane konsumuar edhe elementet e figures se vepres penale te “Sigurimi i mjeteve per vjedhje” ne bashkepunim te parashikuar nga nenet 142 e 25 te K.Penal.

Duke mbajtur ne banese, fisheke luftarake pa lejen e organeve kompetente, ***i pandehuri Aleks Kala*** ka konsumuar edhe elementet e figures se vepres penale te “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit” te parashikuar nga neni 278/2 te K.Penal.

I pandehuri Klaudio Metaj eshte personi i cili ka dijeni per vjedhjen me arme te Viles kater kateshe, rruga “Xhorxh Washington” ne Selite –Tirane qe i perket shtetasit Lorenc Letini (Mustafaj) resident ne shtetin Italian, duke moskallezuar ne organet e ndjekjes penale dhe te rendit publik, nje krim qe eshte kryer ka konsumuar vepren penale te “Moskallzimi i krimit” te parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

I pandehuri Petro Sava eshte personi i cili ka dijeni per vjedhjen me arme te baneses se shtetasit Endri Mosko, duke moskallezuar ne organet e ndjekjes penale dhe te rendit publik, nje krim qe eshte kryer ka konsumuar vepren penale te “Moskallzimi i krimit” te parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

I pandehuri Andi Kraja eshte personi i cili ka dijeni per vjedhjen me arme te baneses se shtetasit Endri Mosko, duke moskallezuar ne organet e ndjekjes penale dhe te rendit

publik, nje krim qe eshte kryer ka konsumuar vepren penale te “Moskallzimi i krimit” te parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Këto rrethana u provuan me:

- Me procesverbalet e deklarimit te shtetasve; Endrit Mosko, Jonida Mosko, Nertil Qazimi, Nevruz Turku, Taulant Braha;
- me procesverbalet per kqyrjen e vendit te ngjarjes se bashku me tabelat fotografike perkatese;
- me procesverbalet per kqyrjen e banesave;
- me kontraten e qerese te lidhur me shtetasin Nertil Qazimi per mjetin me targa AA419 SB;
- me informacionin e marre nga kompanite celulare ne lidhje me numrat telefonike te pandehurve;
- me procesverbalet per sekuestrimin e sendeve prove materiale, celulareve, DVD-R etj;
- ne nje CD-i te administruar me cilesine e proves materiale jane marre te dhenat e regjistruara nga sistemi GPS te vendosur ne mjetin e marre me qera nga autoret;
- me informacionin e marre nga sistemi TIMS per te dyshuarit;
- me procesverbalet per marrjen ne dy cope CD-i te pamjeve filmike te bizneseve prane vendit te ngjarjes te shoqeruar edhe me foto, pamjeve filmike te marketit “Anasa Market”;
- me procesverbalet per administrimin e sms te shkemyera midis shtetasit Endri Mosko dhe te pandehurit Spartak Qoku;
- me procesverbalet per kqyrjen e pamjeve filmike, CD-R (GPS);
- me procesverbalet per kqyrjen e sms nga aparatet telefonike te te dyshuarve;
- me materialin e pergjimeve te disa numrave telefonike celulare;
- me mesazhet e shkemyera midis shtetasit Endri Mosko dhe te dyshuarit Franci Alimi;
- me pamjet filmike te regjistruara nga kamerat e sigurise “01”, te cilat mbulojne nje pjese te rruges “Naim Frasheri”;
- Me procesverbalet per kqyrjen e pamjeve filmike te regjistruara nga kamerat e mesiperme;
- me aktin e ekspertimit balistik nr.6466, dt.22.7.2020 te kryer mbi armen e zjarrit tip pistolete;
- me procesverbalin per kryerjen e kontrollit te baneses se shtetasit Aleks Kola;
- me fisheket luftarake te sekuestruar ne banesen e shtetasit Aleks Kola;
- me aktin e ekspertimit teknik balistik nr.167, date 22.06.2020, te kryer mbi fisheket e gjetur ne banesen e te pandehurit Aleks Kala;
- me informacionin e marre nga sistemi TIMS;
- me deklarimet e pjeseshme te pandehurve Spartak Qoku, Franci Alimi, Aleks Kala, Emel Hajdaraj, Petro Savo, Andi Kraja, Klaudio Metaj dhe, ne teresi me materialet e ketij procedimi penal me nr.3521 te vitit 2020.

Sa siper, bazuar dhe ne nenin 378/1 te K.Pr.Penale i kerkojme Gjykates:

1. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Spartak Qoku, për*** vepren penale te “Vjedhja me arme” kryer ne bashkepunim e mbetur ne tentative e baneses se shtetasit Endri Mosko, parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 te K.Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 12(dymbedhete) vjet burgim.

2. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Spartak Qoku për*** vepren penale “Kanosja per te mos kallezuar”(ne dem te shtetasit Endri Mosko) parashikuar nga neni 311 i K.Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 10(dhete) vjet burgim.

3. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Spartak Qoku*** vepres penale te “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit” te parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 5(pese) vjet burgim.

4. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Spartak Qoku*** per vepren penale te “Vjedhja me arme” kryer ne bashkepunim e mbetur ne tentative e baneses(Vila 4-kateshe) se shtetasit *Lorenc Letini(Mustafaj)* ne Selite- Tirane, duke konsumuar elementet e figures se vepres penale te “Vjedhja me arme” parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 te K. Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 10(dhete) vjet burgim.

5. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Spartak Qoku*** per vepren penale te “Sigurimi i mjeteve per vjedhje” ne bashkepunim te parashikuar nga nenet 142 e 25 te K.Penal(per Argjendarine ne afërsi të “21-Dhjetori”);
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

Ne bashkim te denimeve bazuar ne nenin 55 te K.Penal, denimin e te pandehurit Spartak Qoku me nje denim te vetem prej 16(gjashtembedhete) vjet bugim.

6. ***Deklarimin fajtor te pandehurit Franci Alimi, për*** vepren penale te “Vjedhja me arme” kryer ne bashkepunim e mbetur ne tentative e baneses se shtetasit Endri Mosko, parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 te K.Penal;

Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e

tij me 12(dymbëdhjete) vjet burgim.

7. Deklarimin fajtor të ***pandehurit Franci Alimi*** për veprën penale të “Vjedhja me armë” kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativa e banesës (vila 4kateshe) në shtetasit *Lorenc Letini(Mustafaj)* në Selitë- Tiranë, duke konsumuar elementet e figurës së veprës penale të “Vjedhja me armë” parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 të K. Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqërore e veprës dhe e personit, qendrimin ndaj veprës së kryer, i dënuar edhe me parë, kërkojmë dënimin e tij me 10(dhjetë) vjet burgim.
8. Deklarimin fajtor të ***pandehurit Franci Alimi*** (duke mbajtur në më shumë se një herë, në dy rastet e tentativës së vjedhjes së banesave me armë zjarri pa leje) për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” të parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqërore e veprës dhe e personit, qendrimin ndaj veprës së kryer, i dënuar edhe me parë, kërkojmë dënimin e tij me 7(shtatë) vjet burgim.
9. Deklarimin fajtor të ***pandehurit Franci Alimi***, (duke bërë njohjen e mjedisit ku ndodhë Argjendaria të cilën planifikonin ta vidhnin si dhe duke siguruar mjetet për vjedhje, sikurse është arma e zjarrit dhe makina e cila do të shërbente për transportimin e sendeve të vjedhura) për veprën penale të “Sigurimi i mjeteve për vjedhje” në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 142 e 25 të K.Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqërore e veprës dhe e personit, qendrimin ndaj veprës së kryer, i dënuar edhe me parë, kërkojmë dënimin e tij me 1(një) vit burgim.

Në bashkim të dënimeve bazuar në nenin 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit ***Franci Alimi*** me një dënim të vetëm prej 16(gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim.
10. ***Deklarimin fajtor të pandehurit Aleks Kala*** për veprën penale të “Vjedhja me armë” parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 të K.Penal (Vjedhja me armë, në bashkëpunim e mbetur në tentativa e banesës së shtetasit Endri Mosko).
Nisur nga rrezikshmeria shoqërore e veprës dhe e personit, qendrimin ndaj veprës së kryer, i dënuar , kërkojmë dënimin e tij me 11(njëmbëdhjetë) vjet burgim.
11. ***Deklarimin fajtor të pandehurit Aleks Kala***, (në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë tentuar të vjedhin me armë Vilen kater kateshe në pronësi të shtetasit *Lorenc Letini(Mustafaj)* në Selitë- Tiranë) për veprën penale të “Vjedhja me armë” parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 të K. Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqërore e veprës dhe e personit, qendrimin ndaj veprës së kryer, kërkojmë dënimin e tij me 10(dhjetë) vjet burgim.

12. ***Deklarimin fajtor te pandehurit Aleks Kala***, (duke bere njohjen e mjedisit ku ndodhej Argjendaria te cilen planifikonin ta vidhnin si dhe duke siguruar mjetet per vjedhje, sikurse eshte arma e zjarrit dhe makina e cila do te sherbente per transportimin e sendeve te vjedhura) per vepren penale te “Sigurimi i mjeteve per vjedhje” ne bashkepunim te parashikuar nga nenet 142 e 25 te K.Penal.
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, kerkojme denimin e tij me 1(nje) vit burgim.

13. ***Deklarimin fajtor te pandehurit Aleks Kala (Duke mbajtur ne banese, fisheke luftarake pa lejen e organeve kompetente,)*** per vepren penale te “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit” te parashikuar nga neni 278/2 te K.Penal.
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, kerkojme denimin e tij me 6(gjashte) muaj burgim.

Ne bashkim te denimeve bazuar ne nenin 55 te K.Penal, denimin e te pandehurit ***Aleks Kala*** me nje denim te vetem prej 11(njembedhjete) vjet burgim

14. ***Deklarimin fajtor te pandehurit Emel Hajdaraj*** per vepren penale te “Vjedhja me arme” parashikuar nga nenet 140- 22 e 25 te K.Penal, (Vjedhja me arme, ne bashkepunim e mbetur ne tentative e baneses se shtetasit Endri Mosko).
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, kerkojme denimin e tij me 11(njembedhjete) vejt burgim.

15. ***Deklarimin fajtor te pandehurit Emel Hajdaraj*** (duke bere njohjen e mjedisit ku ndodhej Argjendaria te cilen planifikonin ta vidhnin si dhe duke siguruar mjetet per vjedhje, sikurse eshte arma e zjarrit dhe makina e cila do te sherbente per transportimin e sendeve te vjedhura,) per vepren penale te “Sigurimi i mjeteve per vjedhje” ne bashkepunim te parashikuar nga nenet 142 e 25 te K.Penal.
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, vleren e sendit te vjedhur, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 1(nje) vit burgim.

Ne bashkim te denimeve bazuar ne nenin 55 te K.Penal, denimin e te pandehurit ***Emel Hajdaraj*** me nje denim te vetem prej 11(njembedhjete) vjet burgim.

16. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Klaudio Metaj*** (i cili ka dijeni per vjedhjen me arme te Viles kater kateshe, rruga “Xhorxh Washington” ne Selite –Tirane qe i perket shtetasit Lorenc Letini(Mustafaj) resident ne shtetin Italian), per vepren penale te “Moskallzimi i krimit” te parashikuar nga neni 300 i K.Penal;
Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres

se kryer, vleren e sendit te vjedhur, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me _3(tre) vjet burgim.

17. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Petro Sava*** (i cili ka dijeni per vjedhjen me arme te baneses se shtetasit Endri Mosko) per vepren penale te “Moskallzimi i krimi” te parashikuar nga neni 300 i K.Penal;

Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, vleren e sendit te vjedhur, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

18. Deklarimin fajtor te ***pandehurit Andi Kraja*** (i cili ka dijeni per vjedhjen me arme te baneses se shtetasit Endri Mosko) per vepren penale te “Moskallzimi i krimi” te parashikuar nga neni 300 i K.Penal;

Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e personit, qendrimin ndaj vepres se kryer, vleren e sendit te vjedhur, i denuar edhe me pare, kerkojme denimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

19. Shpenzimet proceduriale prej _____lekesh ne ngarkim te pandehurve solidarisht.

Tirane me dt.____.11.'21.

PROKURORI

Petrit HYSA